ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-97-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**PBC SH.P.K.**
NUI	**810845985**
Adresa	**Rr.Idriz Gjilani p.n.**
Vendi	**Prishtina**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**038600200**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Bashkim Selmani**
Adresa elektronike	**bs@pbc.group**
Data e parashtrimit të ankesës	**25.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender-loto 1[]Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender-loto 2

Njoftimi për Kontratë: 10.01.2024

Afati i fundit për dorëzim te ofertave: 22.01.2024

Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues: 08.04.2024

Kërkesa për rishqyrtim: 12.04.2024

Vendimi i AK për kërkesën për rishqyrtim:18.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 12.04.2024 kemi dorëzuar kërkese për rishqyrtim, ndërsa me datën 18.04.2024, kemi pranuar vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim. Kërkesën për rishqyrtim se bashku me provat dhe vendimin i gjeni të bashkangjitura ne këtë ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Paragrafin 3 të nenit 52 të Ligjit për Prokurim Publik;
Paragrafin 4 të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik;
Nenin 6 të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik;
Nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik;
Nenin 40 të Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik;
Nenin 47.7 të Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues përmes vendimit të datës 08 prill 2024, përbën devijim (ndryshim) substancial të kritereve të kualifikimit, të shprehura në dosjen e tenderit, sepse:

Në dosjen e tenderit, në specifikat teknike të detyrueshme Aneks 1, **NUK** është kërkuar të ofrohet "*përmbajtje të njësive mësimore te listuara konform kurrikules së Kosovës"* e as "*njësi mësimore të vendosura ne një bibliotekë digjitale ne forme të një sofware elektronik te dedikuar dhe të sigurt online dhe offline"* sic eshte thene ne arsyetimin e vendimit te datës 08 prill 2024.

Por në dosjen e tenderit, specifikat teknike të detyrueshme Aneks 1, kërkesa ka qenë:

"Sherbimi I digjitalizimit perfshine:

1. *Funksionimi i rregullt i platformes 24/7;*
2. *Siguria e plote e te dhenave ne platforme;*
3. *Mirembajtja teknike e secilit funksionalitet ekzistues (module) qe garanton mbarevajtjen e plote te te gjitha funksioneve ekzituese;*
4. *Garantimi i ngarkimit dhe shkarkimit te te gjitha materialeve te nevojshme per funsionimin e plote te platformës;*
5. *Ofrimi i perkrahjes tekinike ne rast te problemeve teknike qe e pamundesojne kyqjen dhe perdorimin e platformës;*
6. *Dorezimi i te gjitha te dhenave te platformes (perfshire arkiven) ne format dixhital te migrueshem pas perfundimit te ketij aktiviteti te njesia e kerkeses.;*

7. *Ofrimin e trajnimit të stafit mësimdhënës të nivelit I-V dhe VI-IX rreth përdorimi të platformës;*
8. *Ofrimin e trajnimit të stafit mësimdhënës të nivelit X-XII rreth përdorimi të platformës;*

Sqarim shtesë: Në specifikacion janë numri I nxënësve të IEA në Prishtinë por vazhdimisht ka lëvizje të nxënësve shkuare/ardhje. Devijimi I lejuar /-30% nga vlera e kontrates".

Provë 1: Faqja 17 e dosjes së tenderit, Aneksi 1. Specifikimet teknike të dëmtueshme e nënvizuar me ngjyre te verdhë.

Pra, siç shihet më sipër, vendimi i juaj e datës 08 prill 2024, është në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit dhe si i tillë shkel paragrafin 3 i nenit 52 dhe paragrafin 4 të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 40 dhe nenin 47.7 të regullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Kompania jonë në përputhje me kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, ka dorëzuar Aneksin 1 të nënshkruar edhe të vulosur.

Provë 2: Faqja 17 e dosjes së tenderit, Aneksi 1. Specifikimet teknike të dëmtueshme e nënvizuar me ngjyre te verdhë.
Provë 3: Faqja 17 e ofertës sonë.

Po ashtu, Autoriteti me vendimin e tij të datës 8 Prill 2024, shkelë edhe Nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Duke marrë parasysh faktet, argumentet dhe provat të paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të obligoj Autoriteti Kontraktues të anulojë vendimin e datës 08 prill 2024 dhe të bëjë vlerësimin e ofertave për të dy lotet në përputhje me kriteret e përcaktuara, siç është edhe detyrë ligjore e çdo Autoriteti Kontraktues.

Shtese nga kërkesa për rishqyrtim.

Ne e kundërshtojmë edhe vendimin e Autoritet Kontraktues të datës 18.04.2024 për kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 12.04.2024, për faktin se:

Autoriteti Kontraktues me vendimin për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim përbën devijim (ndryshim) substancial duke u munduar të ndërroj arsyetimin në vendim të eliminimit të ofertës sonë, datë 08.04.2024 nga "***Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme Ankesin 1***" ne "***Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme në paramase"***, (tabelës së çmimeve).

Tutje, ne si Operatore Ekonomik, jemi të vetëdijshëm se kërkesa për rishqyrtim, duhet të

jetë e njëjtë me ankesën. Por me qenë se Autoriteti Kontraktues, në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, përbën devijim (ndryshim) substancial te vendimit për eliminim të ofertës sonë, nga ***"Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme Ankesin 1"*** në ***"Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme në paramase"***, (tabelë të çmimeve). Ne jemi të obliguar të plotësojmë ankesën tonë nëse nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, merr për bazë vendimi i Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim.

Me qenë se Autoriteti Kontraktues, pretendon se specifikat teknike kanë qenë në paramase, (tabelë të çmimeve), atëherë Autoriteti Kontraktues, ka shkelur edhe paragrafin 1 të nenit 28, të Ligjit për Prokurim Publik në të cilin thuhet "*Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit"*. Ku specifikimet e detyrueshme teknike, çdoherë vendosen në Aneksin 1 të dosës së tenderit, përveç rasteve kur të njëjtat vendosen diku tjetër ose të ndara, por në këtë raste, Autoriteti Kontraktues është i obliguara sipas nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik të përpilojnë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. E ne rastin konkret, Autoriteti Kontraktues NUK ka deklaratë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike siç është i obliguar të specifikoj në njoftimin për kontratë. Rrjedhimisht specifikat teknike në këtë dosje të tenderit kanë qenë në Aneksi 1. – Specifikimet teknike të detyrueshme, ku është kërkuar "ANEKSI 1 DUHET TE NENSHKRUHET DHE VULOSET NGA OE", dhe kërkesat në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, kanë qenë "1. Funksionimi i rregullt i platformes 24/7, 2. Siguria e plote e te dhenave ne platforme, 3. Mirembajtja teknike e secilit funksionalitet ekzistues (module) qe garanton mbarevajtjen e plote te te gjitha funksioneve ekzistuese, 4. Garantimi i ngarkimit dhe shkarkimit te te gjitha materialeve te nevojshme per funsionimin e plote te platformës, 5. Ofrimi i perkrahjes tekinike ne rast te problemeve teknike qe e pamundesojne kyqjen dhe perdorimin e platformës, 6. Dorezimi i te gjitha te dhenave te platformes (perfshire arkiven) ne format dixhital te migrueshem pas perfundimit te ketij aktiviteti te njesia e kërkesës, 7. Ofrimin e trajnimit të stafit mësimdhënës të nivelit I-V dhe VI-IX rreth përdorimi të platformës, 8. Ofrimin e trajnimit të stafit mësimdhënës të nivelit X-XII rreth përdorimi të platformës". **Dhe referuar kërkesave në njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit, oferta e dorëzuar nga ne, i plotëson të gjitha këto.**

Në fund, por jo nga rëndësia, për pjesën që Autoriteti Kontraktues, thotë "*Pra parashtruesi nuk e konteston që nuk e përmbushë këtë kërkesë mirëpo i njëjti pretendon që kjo kërkesë nuk ekziston fare në dosjen e tenderit. Megjithatë figura më sipër e cila është marrë nga paramasa si pjesë integrale e dosjes së tenderit e cila ndërlidhet me aneksin 1-secifikimet teknike të detyrueshme, mund të konfirmohet që kërkesa e kontestuar nga parashtruesi jo vetëm që ka qenë pjesë e dosjes së tenderit mirëpo e njëjta ka qenë e formuluar po ashtu në mënyrë shumë të kjartë sipas LPP*". Ne NUK kemi pranuar asgjë por kemi **atakuar vendimin në të cilin thuhet "Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme Ankesin 1"**. Ne vendim askund **NUK** specifikohet paramasa (tabela e çmimeve) por thuhet "***Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme Ankesin 1***". Pra ne nuk mund të kundërshtojmë diçka që nuk është thënë në vendim të Autoriteti Kontraktues, por vetëm atë që është thënë.

Prove: Vendimi i Autoriteti Kontraktues se bashku me letrën standarde për eliminim te ofertës sonë, date 08.04.2024

Andaj, bazuar në faktet e larte cekura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të

obligoj Autoritetin Kontraktues që lënda të kthehet në rivlerësim për të dy lotet dhe vlerësimi i ofertave të behet në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik sipas kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë edhe në dosje të tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demi material do te përcaktohet pas një ekspertize financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*